



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Praktikum i Gjuhës A

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë: 40 seminare

Viti / Semestri : Viti I ,semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor” në Përkthim dhe Interpretim në Gjuhën Greke dhe Angleze

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Studenti duhet të njohë shumë mirë gjuhën shqipe. Lënda i formon studentët në fushën e morfologjisë shqipe. Në këtë lëndë studentët do të plotësojnë njohuritë e tyre rreth objektit të morfologjisë, pjesëve të ligjëratës, kuptimeve dhe formave gramatikore, si dhe lidhjet e saj me disiplinat e tjera gjuhësore. Duke përvetësuar këto njohuri, studentit do ta ketë më të lehtë të përvetësojë edhe gjuhën e huaj, për të cilën studion. Leksionet do të jenë të përgatitura me format « PowerPoint », çka do ta bëjë më gjithëpërfshirëse lëndën, duke qenë vetë studentët që të plotësojnë apo të japin mendimet e tyre rreth njohurive që kanë për këtë lëndë. Po ashtu edhe ushtrimet praktike do të përgatiten me të njëjtin format, në bazë të leksionit që shpjegohet, dhe aktivizimi i studentëve do të plotësojë edhe ato mangësi që mund të kenë mbetur nga arsimi parauniversitar.

Objektivat specifikë lëndorë:

1.Morfologjia e gjuhës shqipe synon plotësimin e njohuriverreth morfologjisë, objektit, pjesëve të ligjëratës, kuptimeve dhe formave gramatikore, si dhe lidhjet e saj me disiplinat e tjera gjuhësore.

2.Studenti duhet të përfitojë njohuri të përgjithshme lidhur me morfologjinë shqipe dhe të jetë i aftë të dijë të dallojë, të analizojë dhe të interpretojë pjesët e ligjëratës.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të lëndës studentët do të jenë të aftë që të bëjnë analiza morfologjike të fjalëve. Duke përvetësuar gjuhën shqipe, student mund të jetë të aftë të nxjerrin të përbashkëtat dhe dallimet me gjuhën për të cilën ata studiojnë dhe kjo i ndihmon më tepër edhe në përkthim nga një gjuhë në tjetrën.